

# 7 VITE PAS MARRËVESHJES SË PARË PËR NORMALIZIM:

**KU JANË KOSOVA DHE SERBIA  
ME “NORMALIZIM” SOT?**

**PRILL, 2020**





# 7 VITE PAS MARRËVESHJES SË PARË PËR NORMALIZIM:

KU JANË KOSOVA DHE SERBIA ME  
“NORMALIZIM” SOT?

PRILL, 2020

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +383 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Disclaimer: Ky punim i shkurtër është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e punimit është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

# **PËRMBAJTJA**

<b>“MARRËVESHJA E BRUKSELIT” E VITIT 2013 .....</b>	<b>7</b>
MARRËVESHJET PASUESE TË VITIT 2015.....	8
<b>(MOS)ZBATIMI I MARRËVESHJEVE.....</b>	<b>9</b>
<b>PROCESI I TANISHËM I “NORMALIZIMIT”</b>	
<b>MES KOSOVËS DHE SERBISË .....</b>	<b>10</b>
“NORMALIZIMI” GJATË QEVERISË ‘KURTI’ .....	12
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>14</b>

**MARRËVESHJA E PARË E PARIMEVE  
QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN  
E MARRËDHËNIEVE MES KOSOVËS  
DHE SERBISË, ËSHTË NËNSHKRUAR  
MË 19 PRILL TË VITIT 2013 NGA  
KRYEMINISTRAT E DY VENDEVE, NËN  
NDËRMJETËSIMIN E PËRFAQËSUESES  
SË LARTË TË BE-SË PËR POLITIKË TË  
JASHTME DHE SIGURI, BARONESHËS  
CATHERINE ASHTON.**

# “MARRËVESHJA E BRUKSELIT” E VITIT 2013

Pas vendimit të vitit Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me aktin e shpalljes së pavarësisë nga ana e Kosovës, në vitin 2010, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën e cila kërkonte fillimin e dialogut Kosovë-Serbi, nën ndërmjetësimin e BE-së. Në vitin 2011, Kuvendi i Kosovës votoi rezolutë që autorizonte Qeverinë për fillimin e dialogut teknik me Serbinë. Dialogu teknik zgjati deri në fund të vitit 2012, kur Kuvendi miratoi një rezolutë të re që autorizonte ekzekutivin për nisjen e dialogut politik me Serbinë, me qëllim të normalizimit dhe zgjidhjes së problemeve mes dy shteteve. Që nga tetori i vitit 2012, kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Ivica Dačić, zhvilluan dhjetë raunde takimesh, të cilat synonin arritjen e një marrëveshje mbi parimet e përgjithshme të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, është nënshkruar më 19 prill të vitit 2013 nga kryeministrat e dy vendeve, nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Baroneshës Catherine Ashton. Kjo marrëveshje, e ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, më 27 qershor të po atij viti, paraqet aranzhmanin e parë ligjor dhe formal në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Ratifikimi i kësaj marrëveshje në Kuvend i dha asaj karakterin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, të paktën për palën kosovare<sup>1</sup>. Në anën tjetër, Parlamenti i Serbisë nuk e kishte ratifikuar këtë marrëveshje, me

arsyetimin se për Serbinë ajo nuk paraqet marrëveshje mes dy shteteve. Me kërkesën e njërit nga grupet parlamentare të Parlamentit të Serbisë, marrëveshja ishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë, e cila kishte refuzuar trajtimin e saj, duke e vlerësuar atë si të papranueshme, meqë çështja e parashtruar dhe vetë marrëveshja paraqisnin akt politik dhe jo juridik.<sup>2</sup> Kjo marrëveshje, e cila njihet dhe si 'Marrëveshja e Brukselit'; u cilësua si historike nga zyrtarë të lartë të BE-së ndërsa suksesi i arritjes së saj iu atribuua gjithashtu dhe diplomacisë së BE-së.

Marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë shihej si një tentativë e BE-së për zgjidhjen e problemeve midis dy shteteve, ndërsa 15 pikat e saj parashihnin rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me:

- Krijimin e një asociacioni/bashkësie të komunave me shumicë serbe;
- Integrimin e strukturave paralele serbe në veri në kuadër të Policisë së Kosovës;
- Emërimin e komandantit regjional të policisë për katër komunat me shumicë serbe në veri;
- Integrimin e autoriteteve gjyqësore dhe krijimin e një paneli të përbërë me shumicë serbe, për të gjykuar të gjitha rastet e komunave me shumicë serbe, si divizion i Gjykatës së Apelit në Prishtinë;
- Organizimin e zgjedhjeve lokale në komunat veriore me lehtësimin e OSBE dhe në përputhje me ligjet e Kosovës;

1 Për më shumë, shih Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. E qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarrveshjes\\_19prill2013\\_HGXf5EDTG4.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarrveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf)

2 Zoran G. & Pavle D. "Report on the Implementation of the Brussels Agreement (by the Republic of Serbia)". Bureau for Social Research, Beograd, 2015.



**QË NGA TETORI I VITIT 2012,  
KRYEMINISTRI I ATËHERSHËM I  
KOSOVËS, HASHIM THAÇI, DHE AI  
SERBISË, IVICA DAÇIQ, ZHVILLUAN  
DHJETË RAUNDE TAKIMESH, TË  
CILAT SYNONIN ARRITJEN E NJË  
MARRËVESHJE MBI PARIMET E  
PËRGJITHSHME TË NORMALIZIMIT  
TË MARRËDHËNIEVE MES DY  
VENDEVE.**

- Intensifikimin e diskutimeve lidhur me energjinë dhe telekomunikacionin;
- Mospengimin e ndërsjellë në rrugën drejt BE-së.

Për zbatimin e kësaj marrëveshje, në maj të po atij viti, nga palët ishte hartuar një plan i zbatimit<sup>3</sup>, i përbërë prej gjashtë elementeve kryesore: Përshtatjen e kornizës ligjore; Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe; Policinë; Drejtësinë; Zgjedhjet lokale dhe Provizionet e përgjithshme.

## MARRËVESHJET PASUESE TË VITIT 2015

Plani i zbatimit i Marrëveshjes së Brukselit kishte paraparë dhe afate kohore të cilat në pjesën më të madhe nuk ishin respektuar por dhe nevojën për dialog të mëtejshëm politik për zbatimin e së njëjtës. Zhvillimet politike në Kosovë dhe Serbi, zgjedhjet për parlamentin evropian në 2014, sollën një përfaqësuese të lartë të re për politikë të jashtme dhe siguri të BE-së, znj. Federica Mogherini, si dhe një tentativë të re për rifillim të dialogut. Gjatë vitit 2015, nën kryesimin e dy ish-kryeministrave të dy vendeve, Isa Mustafa dhe Aleksandër Vuçiq, Kosova dhe Serbia kishin arritur një bllok të marrëveshjeve, që derivonin nga marrëveshja e 19 prillit.

Marrëveshjet e arritura në vitin 2015, janë si në vijim:

- Marrëveshja për Drejtësi dhe Gjyqësorin, e nënshkruar më 10 shkurt<sup>4</sup>;
- Marrëveshja për shpërbërjen e të ashtuquajturës 'Mbrojtja Civile', e nënshkruar më 26 mars<sup>5</sup>;
- Marrëveshja për njohjen reciproke të policave (sigurimeve) të automjeteve, e nënshkruar më 25 qershor<sup>6</sup>;
- Marrëveshja për Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, e nënshkruar më 25 gusht<sup>7</sup>;
- Konkluzionet për zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë të vitit 2013, të nënshkruara më 25 gusht<sup>8</sup>; si dhe
- Plani i veprimit i telekomunikacionit, i nënshkruar po ashtu më 25 gusht<sup>9</sup>.

3 Për më shumë, shih Planin Zbatues. I qasshëm në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/PlaniZbatues\\_22maj2013\\_DHn8XcsWE3.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/PlaniZbatues_22maj2013_DHn8XcsWE3.pdf)

4 Për më shumë, shih Marrëveshjen për Drejtësinë. E qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_9shkurt2015\\_L43cjlQxen.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_9shkurt2015_L43cjlQxen.pdf)

5 Për më shumë, shih Marrëveshjen për Shpërbërjen e të Ashtuquajturës "Mbrojtja Civile". E qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_26mars2015\\_xgUFxRMDM2.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_26mars2015_xgUFxRMDM2.pdf)

6 Për më shumë, shih Memorandumin e Mirëkuptimit për "Njohjen Reciproke të Sigurimit nga Auto përgjegjësia për Palët e Treta (TPL) dhe marrëveshje për procesimin dhe pagesën e kërkesave". E qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/MemorandumiiMirekuptimit\\_23qershor2015\\_2MXFqivUKj.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/MemorandumiiMirekuptimit_23qershor2015_2MXFqivUKj.pdf)

7 Për më shumë, shih Marrëveshjen për Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. E qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_25gusht2015\\_EVDK4S6aE9.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_25gusht2015_EVDK4S6aE9.pdf)

8 Për më shumë, shih Konkluzionet për zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë. Të qasshme në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/KonkluzionetehtesuesitteBEmbiimplementimineMarreveshjesperEnergjitevitit2013\\_25gusht2015\\_tfgbRYh4vv.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/KonkluzionetehtesuesitteBEmbiimplementimineMarreveshjesperEnergjitevitit2013_25gusht2015_tfgbRYh4vv.pdf)

9 Për më shumë, shih Planin e veprimit të telekomunikacionit. I qasshëm në: [http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/PlaniiperbashketiveprimitperTelekomin\\_FINAL\\_25\\_Gusht\\_2015\\_DHYMcXRwLf.pdf](http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/PlaniiperbashketiveprimitperTelekomin_FINAL_25_Gusht_2015_DHYMcXRwLf.pdf)





# (MOS)ZBATIMI I MARRËVESHJEVE

Përkundër bujës së madhe pas arritjes së Marrëveshjes së Parë dhe marrëveshjeve tjera pasuese, një pjesë e tyre edhe sot mbesin të pazbatuara. Madje, edhe pse këto marrëveshje kanë pasur për synim përmirësimin e jetës së qytetarëve, një pjesë e konsiderueshme e këtyre të fundit (43.3%) në shtator të vitit 2016, nuk ishin në dijeni për asnjë prej marrëveshjeve të arritura në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi.<sup>10</sup>

Fakti që marrëveshjet e arritura kanë evituar pothuajse në çdo rast çështjen e statusit politik të Kosovës, është kthyer shpeshherë në problem për zbatimin e aspekteve të caktuara të marrëveshjeve. Marrëveshjet janë arritur në frymën e të ashtuquajturit ambiguitet konstruktiv, që i krijoi hapësirë palëve për të bërë interpretimet e tyre të pavarura të marrëveshjeve. Në anën tjetër, mungesa e mekanizmave garantues dhe mbikëqyrës të zbatimit të marrëveshjeve, si dhe mungesa e vullnetit politik të palëve për zbatimin e tyre, i ktheu një pjesë të marrëveshjeve në dokumente të pazbatuara.

Në këtë drejtim, BE-ja si lehtësuese e procesit, vendosi të luaj rol pasiv në ofrimin e interpretimeve objektive dhe të paanshme mbi këto marrëveshje. Pavarësisht, deklaratave të vazhdueshme të zyrtarëve të BE-së për nevojën e zbatimit të marrëveshjeve, Bashkimi Evropian nuk morri rolin e garantuesit, por ndërliði rrugëtimin evropian të palëve me procesin e dialogut – në anën e Kosovës

duke e përfshirë si obligim në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ndërsa me Serbinë në kuadër të kornizës negociuese në kapitullin 35. Nevoja për një rol të shtuar të garantimit të zbatimit të marrëveshjeve, kishte qenë dhe kërkesë e qytetarëve të Kosovës, të cilët kërkuan që BE-ja të garantojë zbatimin e marrëveshjeve, duke përfshirë dhe nevojën për shqiptim të sanksioneve për palët moszbatuese.<sup>11</sup>

Faktor determinues për moszbatimin të marrëveshjeve ishin dhe zhvillimet politike e shoqërore brenda vendeve duke ndikuar që palët të kenë rezerva apo të mos respektojnë fare marrëveshje të caktuara. Në rastin e Kosovës, polarizimi i skajshëm i spektrit politik lidhur me çështjen e Asociacionit, kishte ndikuar në moszbatim të marrëveshjes përkatëse. Kundërshtimi i ashpër politik, kishte bërë që Marrëveshja e vitit 2015, për Parimet Themelore për Krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, të dërgohej në Gjykatë Kushtetuese nga ish Presidentja Atifete Jahjaga. Në bazë të aktgjykimit, Gjykata kishte gjetur që 20 nene të kësaj marrëveshje nuk janë në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>12</sup> Lidhur me krijimin e Asociacionit, sipas matjes së perceptimit qytetar në shtator të vitit 2017, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve, përkatësisht 46% e tyre, kanë deklaruar se sipas tyre ky Asociacion do të ndikonte në përqesimin e raporteve ndëretnike në Kosovë.<sup>13</sup>

10 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "Transparenca e Dialogut Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i qytetarëve". Fq. 4. Prishtinë, 2016. I qasshëm në: <http://votaim.org/Public/Article/DownloadFile/1004>

11 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "Faza përmbyllëse e dialogut Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i qytetarëve". Fq. 14. Prishtinë, 2017. I qasshëm në: <http://votaim.org/Public/Article/DownloadFile/1258>

12 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, i qasshëm në: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf)

13 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "6 vite pas: (Mos)Konsolidim i shtetësisë - Këndvështrimi i qytetarëve rreth dialogut Kosovë Serbi". Fq. 17. Prishtinë, 2017. I qasshëm në: <http://votaim.org/Public/Article/DownloadFile/1255>

# PROCESI I TANISHËM I "NORMALIZIMIT" MES KOSOVËS DHE SERBISË

Marrëveshjet e Brukselit synojnë normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Në mungesë të një interpretimi të vetëm të nocionit 'normalizim', palët ashtu siç kishin vepruar me interpretimin e marrëveshjeve të arritura, interpretuan normalizimin në bazë të pozicionit të tyre rreth statusit të Kosovës. Mosdefinimi i qartë i "normalizimit" dhe premisave të tij, ka bërë që palët të ndër marrin shpesh veprime që kanë shkuar kundër frymës së normalizimit të marrëdhënieve duke ndikuar që marrëdhëniet në mes tyre jo rrallë herë të acaroheshin.

Kulmi i acarimit të raporteve deri në shkëputje të pothuajse çdo komunikimi ndodhi pasi Kosova vendosi tarifën prej 100% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina më 21 nëntor të vitit 2018.<sup>14</sup> Kjo tarifë ishte vendosur si kundërpërgjigje e institucioneve të Republikës së Kosovës ndaj fushatës agresive të Serbisë për pengimin e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, si dhe kampanjës së kësaj të fundit për tërheqjen e njohjeve të Kosovës.<sup>15</sup>

Tarifa ishte përdorur tutje si pretekst nga ana e palës serbe për mospjesëmarrje në dialog duke iniciuar kështu një periudhë gjatë së cilës palët kishin mbetur të betonuara

në qëndrimet e tyre. Që nga vendosja e tarifës, Kosova është ballafaquar me presion të madh të bashkësisë ndërkombëtare, si të BE-së ashtu dhe të SHBA-ve, për, fillimisht heqjen, më pastaj pezullimin e saj e në fund sërish heqjen e plotë të saj.

Mungesës së normalizimit i ka kontribuar jashtëzakonisht shumë edhe fushata e kohëve të fundit nga ana e Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Republikës së Kosovës, e cila ishte dënuar, mbase jo në masën e duhur, nga faktori ndërkombëtar. Pas vendosjes së tarifës, kur dialogu veçse ishte ndërprerë, kryeministri i atëhershëm Ramush Haradinaj, kishte drejtuar akuza të shumta ndaj Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini, për lejimin e një dialogu jo-transparent, në të cilin ishte diskutuar për çështjen e ndryshimit të territoreve mes dy vendeve. Në fakt, pikërisht ideja për korrigjim të kufijve apo shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës e Serbisë, që është kundërshtuar si zgjidhje nga pjesa dërrmuese e qytetarëve të Kosovës<sup>16</sup>, është një prej temave më të ndjeshme që ka prodhuar polarizim në skenën politike vendore, por edhe në atë ndërkombëtare, ku kryesisht qarkullonin dy qëndrime – ai i dy vendeve kryesore të BE-së, Gjermanisë dhe Francës që kundërshtonin

14 Për më shumë, shih vendimin e Qeverisë për vendosjen e tarifës 100% ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. I qasshëm në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Vendimet-e-Mbledhjes-së-76-të-të-Qeverisë-së-Republikës-së-Kosovës-2018.pdf>

15 Në arsyetimin e vendimit për vendosjen e tarifës përmenden edhe barrierat jo-tarifore që Serbia ka aplikuar ndaj Kosovës përgjatë viteve.

16 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "Hulumtim i opinionit publik lidhur me dialogun Kosovë-Serbi". Fq. 9. Prishtinë, 2018. I qasshëm në: <http://votajme.org/Public/Article/DownloadFile/1980>

idenë e ndryshimit të kufijve, si dhe ai i SHBA-ve që nuk paragjykonte se çfarë do të duhej të përmbante marrëveshja eventuale mes dy vendeve.

Duke qenë se viti 2019 ishte vit zgjedhor edhe për vetë BE-në, kjo kishte rezultuar me pasivizim të mëtutjeshëm të rolit të saj për rifillim të dialogut. Kësaj i ishte shtuar fakti që edhe dy shtetet kryesore të BE-së, Gjermania dhe Franca, kishin dështuar që të shtynjë palët t'i kthehen dialogut<sup>17</sup>. Në këtë kontekst, organizimi i zgjedhjeve në Kosovë gjatë mesit të vitit 2019, si dhe vonesat e ndërlydhura me procesin zgjedhor dhe ato në formimin e institucioneve, kishin ndikuar në shtyrjen e mëtutjeshme të rifillimit të dialogut.

Situata kishte filluar të ndryshojë gjatë fundit të vitit 2019 pas përfshirjes së drejtpërdrejtë amerikane në ndërmjetësimin e procesit dialogues mes palëve. Përfshirja e drejtpërdrejtë ishte formalizuar pas emërimit të Matthew Palmer nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, si përfaqësues i posaçëm për Ballkanin në gusht të vitit 2019<sup>18</sup>, si dhe caktimit të Richard Grenell si i dërguar i posaçëm i Presidentit të SHBA-ve, për arritjen e marrëveshjes së paqes mes dy vendeve<sup>20</sup>. Kosova dhe Serbia, gjatë fillimit të vitit 2020, nën ndërmjetësimin e drejtpërdrejtë të SHBA-ve, përkatësisht të Richard Grenell, kishin nënshkruar një sërë marrëveshjesh të reja, në formën e letrave të qëllimit, lidhur me linjën ajrore, linjën hekurudhore dhe autostradën që lidhë dy vendet. Këto marrëveshje ishin proklamuar si mundësi për vazhdimin e procesit të dialogut drejt arritjes së një marrëveshje përfundimtare bazuar në modelin e zhvillimit ekonomik.

**KULMI I ACARIMIT TË RAPORTEVE  
DERI NË SHKËPUTJE TË POTHUAJSE  
ÇDO KOMUNIKIMI NDODHI PASI  
KOSOVA KISHTE VENDOSUR TARIFËN  
PREJ 100% NDAJ PRODUKTEVE TË  
IMPORTUARA NGA SERBIA DHE BOSNJE  
E HERCEGOVINA MË 21 NËNTOR TË  
VITIT 2018.**

Megjithatë, vlen të përmendet se këto marrëveshje ishin arritur pas një procesi jo transparent të negociimit.<sup>21</sup>

Përkundër thirrjeve të shpeshta të pjesës dërrmuese të spektrit politik kosovar, por edhe disponimit të përgjithshëm qytetar<sup>22</sup> për përfshirje të drejtpërdrejtë amerikane në këtë proces, hipotezat e shumta lidhur me mundësinë e ekzistimit të një plani tashmë<sup>23</sup> të dakorduar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Kosovë-Serbi, kanë ngjallur një frikë dhe hezitim tek kryeministri në detyrë Albin Kurti<sup>24</sup> dhe subjekti politik të cilin ai drejton, se një marrëveshje e tillë, që mund të jetë negociuar mes presidentëve të dy vendeve, mund të mos jetë në favor të Kosovës.<sup>25</sup>

17 Për më shumë, shih lajmin: <https://zeri.info/aktuale/268822/desh-ton-samiti-i-parisit/>

18 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.dw.com/sq/samiti-i-berlinit-kosova-dhe-serbia-nuk-afrohen/a-48541618>

19 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.koha.net/arberi/181795/matthew-palmer-emerohet-perfaqesues-i-posacem-i-shba-se-per-ballkanin/>

20 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.politico.eu/article/trump-names-ric-grenell-his-special-envoy-for-serbia-and-kosovo/>

21 Për më shumë, shih lajmin: <https://zeri.info/aktuale/320950/kdi-kerkon-me-shume-transparence-per-marrevshjen-ne-berlin/>

22 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i qytetarëve". Fq. 12. Prishtinë, 2018. I qasshëm në: <http://votaim.org/Public/Article/DownloadFile/1388>

23 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.koha.net/metro/194362/hooper-marrevshja-kosove-serbi-ekziston-ceshtja-eshte-zbatimi/>

24 Për më shumë, shih lajmin: <https://kallxo.com/lajm/albin-kurti-qeveria-ime-po-bie-per-shkakt-te-marrevshjes-me-serbine/>

25 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.evropaelire.org/a/albin-kurti-marrevshje-sekrete-thaci-vuciq-/30482110.html>

## "NORMALIZIMI" GJATË QEVERISË 'KURTI'

Që nga viti 2013, kur ishte arritur Marrëveshja e Parë e Normalizimit, Kosova ka ndërruar katër qeveri, të cilat ndonëse në parim kanë qenë 'pro' dialogut, kanë pasur qasje relativisht të ndryshme lidhur me procesin, si dhe masat e veprimet që duhet ndërmarrë gjatë tij.

Së fundi, qeveria e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, e formuar në muajin shkurt të këtij viti, e shprehur formalisht 'pro' vazhdimit të procesit, kishte refuzuar heqjen e plotë të tarifës 100%, pa vendosjen e reciprocitetit, ndryshe nga ç'ishte kërkuar në vazhdimësi dhe me këmbëngulje nga zyrtarët më të lartë amerikanë, që ishin të përfshirë në këtë proces. E pikërisht ky refuzim, ishte përdorur si një nga arsyetimet e rrëzimit të kësaj qeverie nga partneri i koalicionit qeverisës, Lidhja Demokratike e Kosovës, me mbështetjen e partive tjera opozitare.

Edhe pse tarifa ishte hequr pjesërisht me anë të një vendimi të marrë nga Qeveria më 20 mars<sup>26</sup>, kjo ishte vlerësuar si e pamjaftueshme nga zyrtarët amerikanë, të cilët edhe praktikisht kanë marrë barrën e përmbylljes së procesit të dialogut.<sup>27</sup> Kërkesa e këtyre të fundit për heqje të plotë dhe pa kushte e tarifës nuk ishte përfillur, meqë më 31 mars Qeveria në detyrë kishte marrë vendim për zëvendësim të tarifës me reciprocitet ndaj Serbisë. Megjithatë, vendimi i Qeverisë për heqjen e tarifës 100% ishte mbështetur nga shumica e shteteve të BE-së, si dhe nga vetë zyrtarët e BE-së.

Sot, edhe pse dialogu mbetet i pezulluar, nuk ka pasur iniciativa për ndërtimin e konsensusit politik në Kosovë lidhur me këtë çështje. Tarifa 100%, reciprociteti, vijat e kuqe dhe qëndrimi i ndarë i bashkësisë ndërkombëtare në këtë

**QEVERIA E UDHËHEQUR NGA  
KRYEMINISTRI ALBIN KURTI, E  
FORMUAR NË MUAJIN SHKURT TË  
KËTJË VITI, E SHPREHUR FORMALISHT  
'PRO' VAZHDIMIT TË PROCESIT,  
KISHTE REFUZUAR HEQJEN E PLOTË  
TË TARIFËS 100%, PA VENDOSJEN  
E RECIPROCITETIT, NDRYSHE NGA  
Ç'ISHTË KËRKUAR NË VAZHDIMËSI DHE  
ME KËMBËNGULJE NGA ZYRTARËT MË  
TË LARTË AMERIKANË, QË ISHIN TË  
PËRFSHIRË NË KËTË PROCES.**

proces janë disa prej elementeve që kanë ndikuar që partitë politike të mos arrijnë një konsensus më të gjerë lidhur me të gjitha çështjet që ndërlidhen me procesin e dialogut. Madje, në rreth 50 ditë të Qeverisë 'Kurti', por edhe pas shkarkimit të saj, vetëm janë intensifikuar deklaratimet akuzuese të liderëve institucional, veçanërisht Presidentit dhe Kryeministrit. Ndërsa, partitë parlamentare pozitë-opozitë, kanë vijuar përplasjet e tyre politike, që shpeshherë kanë pasur në fokus vetë këtë proces.

26 Për më shumë, shih Vendimin e Qeverisë së Kosovës për plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 01/76 të 21 nëntorit 2018, i ndryshuar me vendimin nr. 06/82 të 28 dhjetorit 2018. I qasshëm në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-së-14-të-të-Qeverisë-së-Republikës-së-Kosovës.pdf>

27 Për më shumë, shih lajmin: <http://top-channel.tv/2020/02/28/shba-kunder-kurtit-grenell-nuk-e-mbeshtesim-heqjen-e-pjesshme-te-taksas/>



Sa i përket rolit të bashkësisë ndërkombëtare në këtë proces, nëse zhvillimet lidhur me dialogun dhe normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi shihen nga një perspektivë më e gjerë, është e lehtë të konkludohet që ekziston një "luftë" e dyfishtë për udhëheqje të këtij procesi. Së pari, ekziston një "luftë" për udhëheqje të këtij procesi brenda dy liderëve institucional të Kosovës, përkatësisht Presidentit Thaçi dhe Kryeministrit në detyrë Kurti. Ndërsa, në planin e jashtëm, ekziston një "luftë" për udhëheqje mes SHBA-ve dhe BE-së<sup>28</sup>. Vetë emërimi i dy emisarëve të posaçëm nga këto dy vende, respektivisht Richard Grenellit nga SHBA-të<sup>29</sup> dhe Miroslav Lajçak nga BE<sup>30</sup>, si dhe iniciativat gati paralele të këtyre për rifillim dhe përmbyllje të këtij procesi, mund të shihen si garë mes dy prej fuqive më të mëdha politike në arenën ndërkombëtare, në përmbylljen e procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Një vëmendje e tillë ndërkombëtare, nga këta dy akterë, mund të sjellë një marrëveshje përfundimtare që përmbyllë mosmarrëveshjet shekullore mes dy vendeve, që deri vonë ishte parë si diçka utopike nga një pjesë e konsiderueshme e akterëve të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.<sup>31</sup>

**ËSHTË E LEHTË TË KONKLUDOHET QË  
EKZISTON NJË "LUFTË" E DYFISHTË  
PËR UDHËHEQJE TË KËTIJ PROCESI.  
SË PARI, EKZISTON NJË "LUFTË" PËR  
UDHËHEQJE TË KËTIJ PROCESI BRENDA  
DY LIDERËVE INSTITUCIONAL TË  
KOSOVËS, PËRKATËSISHT PRESIDENTIT  
THAÇI DHE KRYEMINISTRIT NË  
DETYRË KURTI. NDËRSA, NË PLANIN E  
JASHTËM, EKZISTON NJË "LUFTË" PËR  
UDHËHEQJE MES SHBA-ve DHE BE-së**

28 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.evropaelire.org/a/30459928.html>

29 Për më shumë, shih lajmin: <https://kallxo.com/lajm/richard-grenell-i-derguar-i-shba-se-per-dialogun-kosove-serbi/>

30 Për më shumë, shih: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2020/04/03/belgrade-pristina-dialogue-eu-appoints-a-new-special-representative/>

31 Për më shumë, shih lajmet: <https://www.koha.net/arberi/145487/marreveshja-kosove-ndash-serbi-qindra-mijera-milje-larg/>

<https://ekonomiaonline.com/politike/kosova-e-serbia-ende-larg-arritjes-se-marreveshjes-historike/>  
<https://indeksonline.net/deputeti-i-ldk-se-sqaron-se-pse-marreveshja-me-serbine-eshte-shume-larg/>

<https://gazetablic.com/a-mund-te-arrihet-marreveshja-kosove-serbi-ne-kohe-te-zgjedhjeve-sipas-ish-zyrtarit-amerikan/>





# REKOMANDIME

Duke u bazuar në zhvillimet e fundit lidhur me dialogut mes Kosovës dhe Serbisë në veçanti, por edhe procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve në përgjithësi, Instituti Demokratik i Kosovës ofron rekomandimet, si në vijim:

- I. Marrëveshja eventuale përfundimtare duhet të evitohet "ambiguitetin konstruktiv" në mënyrë që palëve të mos u lejohet interpretimi i ndryshëm e që mund të shpie në moszbatim të vetë marrëveshjes;
- II. Arritja e një marrëveshjeje eventuale përfundimtare duhet të garantohet nga ndërmjetësuesit e këtij procesi. Marrëveshja eventuale duhet të ketë afate strikte të zbatimit, si dhe masa ndëshkuese për palët mos zbatuese;
- III. Institucionet, në bazë të përgjegjësi kushtetuese, duhet të punojnë intensivisht për arritjen e një bashkërendimi institucional lidhur procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Ndërsa, duhet të zhvillohen përpjekje me synimin e arritjes së një pajtueshmërie të spektrit politik lidhur me parimet negociuese dhe përmbajtjen e marrëveshjes eventuale përfundimtare. Këto përpjekje duhet të ndërmerren në funksion të ndërtimit të një qëndrimi unik të shtetit të Kosovës, evitimin e polarizimit politik e shoqëror, forcimin e pozitës negociuese të Kosovës në raport me Serbinë, si dhe ndërtimin e raporteve të shëndosha me të gjithë partnerët ndërkombëtar;
- IV. Secili institucion kushtetues i angazhuar në procesin e dialogut, duke përfshirë Kryeministrin, Presidentin dhe Kuvendin e Kosovës, duhet të ushtrojë obligimet përkatëse kushtetuese në kuadër të këtij procesi, konform aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje;
- V. Transparenca rreth procesit të bisedimeve Kosovë-Serb, si ndaj qytetarëve dhe institucioneve të vendit, duhet të mbetet element kyç. Duhet të hiqet dorë nga praktika e mostransparencës që po e shoqëron ende këtë proces dhe të artikulohe qartë vijat e kuqe, çështjet që synohen të diskutohet në kuadër të këtij procesi, ku pritshmëritë e qytetarëve për temat e dialogut duhet të merren parasysh dhe të mos neglizhohen.







Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**

